



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.916-2/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, Nasret Hajrizi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, **duke vepruar sipas detyrës zyrtare Plotësohet** vendimi Anr.916/2021 i datës 07.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 11.11.2021, mori këtë:

V E N D I M P L O T Ë S U E S

- I. **PLOTËSOHET** vendimi i PZAP-it, Anr.916/2021, i datës 07.11.2021, **Pranohet** i bazuar apeli Anr.916/2021, i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, Nasret Hajrizi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Pejës, kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave për vendvotimin 1705C/07D.
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, në vendvotimin 1705C/07D.
- III. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Paneli me vendimin Anr.916/2021, të datës 07.11.2021, ka vendosur lidhur me apelin Anr.916/2021 të datës 04.11.2021, me përmbajtje si në dispozitiv të vendimit.

Paneli duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka bërë plotësimin e vendimit Anr.916/2021, të datës 11.11.2021, me të cilin ka pranuar si të bazuar apelin lidhur me vendvotimin 1705C/07D. Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimit të lartcekur, nga se rezulton se në Rezultatet përfundimtare nga KQZ, Kandidati për Kuvend Komunal Nasret Hajrizi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, në vendvotimin e lartcekur ka zero (0) vota, ndërsa apelit i ka bashkangjitur deklaratën e votuesit Altin Lokaj, i cili dëshmon se ka votuar për kandidatin e lartcekur në të njëjtin vendvotim, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratën e votuesit.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.916-2/2021 datë 11.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së,